

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 129 Rep.

Nr. 66/v Kol.



KONTRATE SHITJE E KUOTES

Sot, ne Tirane, me datën 29.01.2018 para meje, Dhurata Vardhami, Notere pranë Dhomes se Notereve Tirane, eshte nenshkruar kjo kontrate per shitjen e kuotes (ketu e me poshte quajtur "Kontrata") ndermjet:

- **Z. Daniel Shuaipi**, shtetas shqiptar, lindur ne Erske, me date 24/05/1974, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me numer personal 028392921 (ketu me poshte quajtur "Shitesi")

Dhe

- **NCI Shpk.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, themeluar dhe organizuar ne përputhje me legjislacionin shqiptar, me numër unik identifikimi te subjektit (NUIS) L41709011G, me seli ne adresën: Mjull Bathore, Rruga Akacia, Zona Kadastrale 2704, Nr. Pasurie 465/27, Farke, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar rregullisht nga administratori z. Ergys Halili (ketu e me poshte quajtur "Bleresi")

Bleresi dhe Shitesi ketu me poshte te quajtur bashkerisht "**Palet**" dhe vecmas "**Pala**";

MEQENESE:

- Shoqeria "**ENERGIA PULITA**" Shpk eshte nje shoqeri e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit me numer unik identifikimi te subjektit NUIS K72117502R, me seli ne adresen: Lagjia Nr. 1, Rruga "Taulantia", tek hyrja e portit Nr. 1, tek ish interkubi (prane Agjencise GED), Durres, Shqiperi (ketu me poshte "**Shoqeria**");
- Shoqeria ka per objekt veprimtarie, financimin, projektimin, ndertimin, venien ne pune, administrimin dhe mirembajtjen e HEC-eve, "Gostivisht", "Langarica 3", "Ura e Dashif mbi lumin Gostivisht dhe Langarice, Permet, si dhe prodhimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi, shitja dhe tregtimi i energjise elektrike te prodhuar;
- Kapitali themeltar i Shoqerise eshte i ndare ne 3 (tre) kuota, dhe Shitesi zoteron 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 0.65% te kapitalit themeltar te Shoqerise ("**Kuota**");
- Bleresi ka per qellim te bleje Kuoten dhe Shitesi ka per qellim te shese respektivisht tek Bleresi pjesen e tij te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar e cila perfaqeson 0.65 % te kapitalit te Shoqerise;

- E. Ortaku i Vetem i Bleresit me date 26/01/2018 ka miratuar blerjen e Kuotes te Shitesit sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate;
- F. Asambleja e Ortakeve e Shoqerise me date 26/01/2018 ka miratuar transferimin e Kuotes nga Shitesi tek Bleresi sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate.

Sa me sipër, Palet bien dakord si me poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontrates

Ne perputhje me kushtet dhe dispozitat e kesaj Kontrate, Shitesi bie dakord t'i transferoje nepermjet shitjes Bleresit, dhe Bleresi bie dakord te bleje nga Shitesi, te lire nga çdo peng ose barre, kundrejt shperblimit te percaktuar ne Nenin 2 te kesaj Kontrate i cili do te shlyhet sipas menyres se treguar ne Nenin 2.

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe Transferimi i Pronesise se Kuotes

- 2.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesi transferon nepermjet shitjes tek Bleresi dhe Bleresi blen nga Shitesi 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 0.65% te kapitalit themeltar te Shoqerise, kundrejt çmimit te pergjithshem prej 30.000 Euro (**tridhjetemije**), i cili do te paguhet nepermjet transferes bankare prane llogarise bankare qe Shitesi i ka njoftuar Bleresit.
- 2.2 Çmimi i Shitjes do te paguhet ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate.
- 2.3 Transferimi i pronesise se Kuotes nga Shitesi tek Bleresi kryhet menjëherë ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate.

Neni 3

Deklarime dhe Garanci te Shitesit

- 3.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, Shitesi deklaroi dhe garantoi se:
- (i) Eshte zoterues i vetem e i ligjshem i Kuotes te percaktuara ne nenet e mesiperme te kesaj Kontrate;
 - (ii) Kuota eshte e lire nga çdo peng apo barre dhe Shitesi gezon te drejten, kompetencen dhe autoritetin e plote te shese, kaloje dhe transferoje Kuoten ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate;
 - (iii) Shitesi ka te gjitha kompetencat per te nenshkruar dhe ekzekutuar kete Kontrate dhe kjo Kontrate perben nje detyrim te vlefshem te Shitesit, te zbatueshem ne perputhje me kushtet e saj;

- (iv) Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate nuk do te perbeje shkelje te asnje marreveshje, kontrate ose detyrimi tjeter te marre persiper nga Shitesi.

3.2 Shitesi garanton se me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe me hyrjen e saj ne fuqi per Palet:

- (i) Shitesi humbet çdo te drejte pronesie, per ndarje dividendin dhe çdo te drejte tjeter qe rrjedh nga zoterimi i Kuotes te kapitalit te Shoqerise dhe Bleresi behet pronar i vetem i ligjshem i Kuotes;
- (ii) Bleresi do te kete te drejten e çdo dividendi dhe çdo te drejte tjeter qe rrjedh nga zoterimi i Kuotes dhe nga momenti nenshkrimit te kesaj kontrate Shitesi nuk do te kete asnje te drejte mbi Kuoten objekt i kesaj Kontrate. Çdo e drejte apo te drejta per dividend perpara nenshkrimit te kesaj Kontrate perfitohen nga Shitesi.
- (iii) Ne rast mosmarreveshjeje per shkak te Kuotes midis Shitesit dhe paleve te treta, Shitesi duhet ta zgjidhe ate personalisht pa penguar Bleresin te gezoje lirshem Kuoten e blere sipas kesaj Kontrate. Shitesi eshte pergjegjes kundrejt te treteve per te gjitha pretendimet qe rrjedhin ne lidhje me transaksionet e ndermarra perpara transferimit te pronesise tek Bleresi dhe eshte i detyruar te demshperblejne Bleresin per çdo dem apo humbje te pesuar nga ky i fundit per shkak te pretendimeve te paleve te treta ne lidhje me Kuoten.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci te Bleresit

4.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate, Bleresi deklaron dhe garanton se:

- (i) nuk ka asnje pengese ligjore per lidhjen e kesaj Kontrate;
- (ii) se ka te gjitha kompetencat per te nenshkruar dhe permbushur kete Kontrate dhe kjo Kontrate perben nje detyrim te vlefshem te Bleresit te zbatueshem ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate;
- (iii) se eshte i afte te paguaje tek Shitesi çmimin e percaktuar sipas Nenit 2 te kesaj Kontrate;
- (iv) ka marre te gjitha autorizimet dhe miratimet e nevojshme nga per transferimin e Kuotes objekt i kesaj Kontrate.

Neni 5

Veçueshmeria

5.1 Ne rast se ndonje dispozite apo detyrim i kesaj Kontrate do te rezultojte i pavlefshem, i paligjshem apo i pazbatueshem sipas nje juridiksioni, vlefshmeria, ligjshmeria dhe

Neni 9

Konfidencialiteti

Secila nga Palet detyrohet te ruaje konfidencialitetin ne lidhje me permbajtjen e kesaj Kontrate, kushtet e saj, si dhe çdo informacion tjeter qe Palet kane shkëmbyer ose qe jane vene ne dijeni gjate negocimeve per nenshkrimin e kesaj Kontrate.

Neni 10

Ligji i zbatueshem

10.1 Kjo Kontrate, si dhe te drejtat e detyrimet qe rrjedhin per Palet nga kjo Kontrate do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar

10.2 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote midis Paleve ne lidhje me çeshtjen objekt i kesaj Kontrate, dhe mbizoteron mbi te gjitha marreveshjet e meparshme me shkrim ose me goje, si dhe mbi te gjitha komunikimet ndermjet Paleve ne lidhje me çeshtjen objekt i kesaj Kontrate.

10.3 Pervec kur eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate, çdo ndryshim i saj mund te kryhet vetem me shkrim dhe te nenshkruhet nga te dyja Palet.

Pasi iu lexua me ze te larte e te qarte Paleve, qe te gjeten permbajtjen e kesaj Kontrate ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, te nenshkruajne ate rregullisht para meje, ne 4 (katër) kopje me te njëjtën vlere secila, dhe une Notori vërtetoj sa me siper sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

SHITESI


Daniel SHUAIP





NOTERI





BLERESI


Per NCI Shpk

